



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:043839
Datë: 26.06.2024
Numri i dokumentit: 05859888

Ac.nr.4609/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca – Dula, kryetare e kolegjit, Naime Ahmeti dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.H nga Gj....., të cilin me autorizim e përfaqëson Av.K.A-S, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.M Zyrtar i Lartë Ligjorë në Komunën e Gjilanit, për kompensimin e pagave jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.744/2020, të datës 05.05.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 18.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.744/2020, të datës 05.05.2022, në pikën I të dispozitivit, sa i përket shpërblimit jubilar dhe gjykohet si në vijim: REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses A.H nga Gj....., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj shumën prej 210.50 euro, në vlerë të 50% të një page bazë, si e pa themeltë.

II. REFUZOHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.744/2020, të datës 05.05.2022, në pikën I të dispozitivit lidhur me kompensim të shpenzimeve për ushqim gjatë punës, kamatës së gjykuar, si dhe pika II e dispozitivit për shpenzimet e procedurës, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.744/2020, të datës 05.05.2022, ka vendosur si në vijim: *“I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.H nga Gj....., dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të kërkesës për kompensim të shpenzimeve të ushqimit ditor t’ia paguaj shumën prej 1,904.00 euro, si dhe në emër të kërkesës për kompensim të shpërblimit jubilar, për mbi 10 vite përvojë pune në vlerë të 50% të një page bazë, t’ia paguaj shumën prej 210.50 euro, apo shumën e përgjithshme prej 2,114.50 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.*

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, që paditëses A.H nga Gj....., t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: 104 euro për përpilimin e padisë, 31 euro për taksë gjyqësore për padinë e parashtruar, dhe 135 euro për përfaqësimin e paditësit nga avokati për një seancë gjyqësore, apo shumën e përgjithshme prej 270 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më dhunë”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, ashtu që të ndryshohet aktgjykimin i atakuar dhe të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses në këtë çështje si e pa bazuar në ligj ose të prishet aktgjykimin i atakuar dhe të kthehet rasti në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësja.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e së paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja, pranë gjykatës së shkallës së parë, me dt. 13.03.2020, ka ushtruar padi, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria e Arsimit në Gjilan, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë dhe shpërblimit jubilar. Me padi, precizimin e saj me parashtrësën e dt. 10.02.2021 ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 15 vite përvojë pune, në vlerë 50% të një page bazë, t’ia paguaj shumën prej 210.50 euro, kurse në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 – 11.03.2020 për 629 ditë pune t’ia paguaj shumën 1.258 euro, pra shumën e përgjithshme 1.468,50 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit, si dhe shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses dhe precizimit të saj, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.744/2020 të dt.05.05.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se e njëjta punon si mësimdhënëse e gjuhës angleze në SH.F.M.U “.....” në Gj..... dhe realizon të ardhura mujore prej 421 euro, e cila vërtetohet nga lista e pagave të Buxhetit të Republikës së Kosovës, ka përvojë pune 15 vite e cila vërtetohet nga vërtetimi i përvojës së punës nr.03/691 i datës 18.12.2019 dhe si ditë të pranisë në punë prej datës 18.04.2017 – 11.03.2020 paditësja ka 629 ditë të pranisë në punë.

Gjykata duke u bazuar në nenin 35 par. 7 dhe 8 pika 8.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt. 18.04.2017, gjeti se kërkesëpadia është e bazuar, andaj edhe vendosi sikur në dispozitiv të aktgjykimit. Pretendimet e të paditurit se paditëses i mungon baza ligjore, i refuzoi si të pa bazuara duke u bazuar në nenin 90 të Ligjit të Punës dhe nenit 245 të LMD –së, ndërsa pretendimet rreth parashkrimit të kërkesës i refuzoi, duke iu referuar nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që padinë paditësja e ka parashtruar me 13.03.2020, ndërsa kontrata ka hyrë në fuqi me dt. 18.04.2017 pra brenda afatit. Për kamatën vendosi duke u mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet konform nenit 449, 452 dhe 463.1 të LPK-së

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën e të paditurës brenda kufijve të saj, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m), si dhe për zbatimin e së drejtës materiale, konform nenit 194 të LPK-së, vjen në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat gjykata e shkallës së dytë i vëren sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera që pretendohet me ankesë, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, e drejta materiale është zbatuar drejtë sa i përket mënyrës së vendosjes për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpërblimin jubilar dhe për këtë pjesë është dashur që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se në rastin konkret lidhur me shpërblimin jubilar gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, meqenëse gjykata e shkallës së parë gabimisht i është referuar nenit 35 par. 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 dhe po ashtu gabimisht ka interpretuar institutin e parashkrimit në këtë rast. Nga provat e administruara konkretisht nga vërtetimi i shkollës nr.03/691 i datës 18.12.2019, vërtetohet se paditësja ka 15 vite përvojë pune, nga çka rezulton se vitin jubilar ose vitin e 10 të përvojës së punës si kusht për të kërkuar kompensimin e pagës jubilarë, e ka arritur në vitin 2014, kur nuk kanë qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar e dt.11.04.2014 e as Kontrata Kolektive e Arsimit e dt.18.04.2017 apo ndonjë marrëveshje tjetër kolektive. Prandaj edhe

kërkesës së paditëses për shpërblim jubilar i mungon baza juridike, për të kërkuar një gjë të tillë, prandaj edhe është dashur të refuzohet kërkesa e paditëses për shpërblim jubilar në shumë prej 210.50 €.

Gjykata e Apelit e ka vërtetuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me kompensimin e shujtave-ushqimit për ditët e pranisë në punë, sepse me dispozitën e nenit 35 par.7 të kësaj Kontratës Kolektive të Arsimit e cila ka hyrë në fuqi 18.04.2017, përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluara ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*, andaj, gjykata me të drejtë e aprovoi kërkesëpadinë e paditëses në këtë pjesë, pasi që u vërtetua që paditësja nuk ka realizuar të drejtën për ushqim gjatë pranisë në punë, konkretisht për 629 ditë, për periudhën 18.04.2017 deri me 11.03.2020, e drejtë kjo e cila buron nga kontrata kolektive e lartcekur.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’i paguaj ushqimin – shujtat për ditët e pranisë në punë, me të drejtë është bazuar në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit e lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, (MASHT) dhe Sindikatës Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, (SBASHK), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, ndërsa paditësja ka kërkuar kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë për periudhën prej 18.04.2018 deri me dt.11.03.2020 që do të thotë për periudhën brenda kontratës, po ashtu kjo marrëveshje - kontratë ka qenë në fuqi në momentin e parashtrimit të padisë pra dt. 13.03.2020, dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës, nga rrjedh themelësia e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vendosi sikur në pikën II të dispozitivit, duke e vërtetuar aktgjykimin e atakuar në pjesën me të cilin është vendosur lidhur me kompensimin e shpenzimeve për ushqimin në punë, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me: dispozitën e nenit 67 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet. a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 4 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*. Andaj duke iu referuar dispozitave të lartcekura pretendimet e të paditurës sa i përket asaj se e njëjta nuk është nënshkruese e kontratës dhe se e njëjta nuk është palë që ka marr obligime, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pa themelta.

Drejtë del të jetë vendosur edhe lidhur me kamatën e gjykuar, për faktin se e njëjta është gjykuar në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, e po ashtu edhe lidhur me shpenzimet e procedurës duke iu referuar nenit 449, 452 dhe 463.1 të LPK –së.

Nga arsyet e paraqitura Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar dhe ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket shpërblimit jubilar, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar për pjesën tjetër sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk patën ndikim në vendosje ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lart, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika d) dhe e) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4609/2022, me datë 18.06.2024

Kryetare e kolegjit
Nora Bllaca – Dula, d.v.